

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Syla i përgjigjet Vuçiqit: Po vazhdon propagandën e kohës së Millosheviqit
ADRESA	https://indeksonline.net/syla-i-pergjigjet-vuciqit-po-vazhdon-propaganden-e-kohes-se-millosheviqit/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 23:49:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 07:59:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	96fc376f938cad717032e54d0194abadd2bf10c86534fe3c74be50707241e516
TEKSTI	dd978ef9f7f047ba4579b1dad2b888a53c96258b7c814550faa6a0b0558f241e
PAMJA	7efe3203b92a1082cb0d319832a6dc4bb16bd3d2b21e19a35156c0df67664a56

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72f0d66e9681d252415655a058a3cf64b750ea181cfc50d0a9fe2c26f73c14f4
E MËPARSHMJA	615f22304adb50f5f3c474a11c7846d59b776e629ee307a07360eb66f220da09
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/72f0d66e9681d252415655a058a3cf64b750ea181cfc50d0a9fe2c26f73c14f4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)







SHPËRNDAJE







09:59 / E Shtunë, 05 Shtator 2026 / B XH

Syla i përgjigjet Vuçiqit: Po vazhdon propagandën e kohës së Millosheviqit



Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVL- UÇK), Gazmend Syla, ka reaguar ndaj deklaratave të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, lidhur me marshin e paralajmëruar në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe zhvillimet rreth procesit gjyqësor në Hagë.

Ndaj këtyre deklaratave, Syla në një intervistë për Ekonomia Online ka thënë se në Organizatën e Veteranëve të Luftës nuk presin deklarata të tjera nga Vuçiqi, duke e cilësuar atë si ish-ministër të propagandës në kohën e regjimit të Slobodan Millosheviqit.

“Në si Organizatë e Veteranëve të Luftës nuk presim deklarata të tjera prej një ish-ministri të Millosheviqit në kohën e luftës. Ju e dini, ky ka qenë ministër i propagandës, është tamam në zhargonin e tij, kjo i shkon propagandës së atij vendi. Ne si ish-ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës as në kohën e luftës kur ishim me Serbinë në vitin ’98-’99 asnjëherë nuk kemi pasur cak sulmi apo asnjëherë nuk i kemi kthyer tyta e pushkë civilëve. Përndryshe ata kanë bërë një gjë të tillë, do të thotë ata i kanë vlarë civilët tanë këtu. Edhe në këtë rast që presim lajme të mira me datën 16, lirin e tyre, po eventualisht edhe me pasur ndonjë lajm tjetër, si ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ne kemi treguar trimërinë tonë atëherë, do ta tregojmë edhe nëse është nevoja edhe tash. Po asnjëherë duke provuar, siç ai ka pretenduar, ne eventualisht me përdorë ndonjë dhunë mbi civilët serbë që janë këtu apo komunitetet e tjera, kështu që nuk qëndrojnë fare. Ne frikën nuk mundemi me ia hequr presidentit Vuçiq, por nuk duhet të ketë frikë për atë punë sepse ne kemi dëshmuar që asnjëherë nuk kemi bërë apo nuk kemi ushtruar dhunë mbi civilët e pafajshëm, kështu që nuk ka nevojë me u shqetësuar për këtë punë fare”, tha Syla.

Syla është ndalur edhe te roli që, sipas tij, Serbia ka pasur në procesin që lidhet me Gjykatën Speciale, duke pretenduar se Beogradi ka përdorur propagandën dhe ka ushtruar përpjekje për të ndikuar në opinionin ndërkombëtar dhe në procesin gjyqësor.

“Serbia prej themelimit të Gjykatës Speciale, po edhe më herët, po prej themelimit të saj kjo ka kontribuar domethënë në këtë formë kështu: me propagandën e saj, me provuar me bërë edhe ndërkombëtarëve me iu bërë presion që sikurse edhe me ndikuar në vertiklin tonë. Pse jo? Ju e dini që në fund kjo dërgoi edhe prova, kështu si prova, dokumente shtesë nga prokuroria e Serbisë që i mbledh Serbia dhe i dërgojnë në Prokurorinë Speciale, Gjykatën Speciale. Prandaj edhe paneli, trupi gjyqësor i pranoi ato prova t’i trajtojë. Për neve është shokuese kjo”, ka thënë ai për Ekonomia Online.

Nënkryetari i OVL-UÇK-së ka folur edhe për mbështetjen e organizatës ndaj protestave dhe marshit në përkrahje të ish-krerëve të UÇK-së.

Ai ka theksuar se, pavarësisht se OVL-UÇK nuk është pjesë e bashkorganizimit aktual, organizata do ta mbështesë fuqishëm çdo protestë që lidhet me atë që e konsideron padrejtësi ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

“Ne si Organizatë e Veteranëve të Luftës, edhe pse nuk jemi sot në bashkorganizim, po që e mbështesim fuqishëm jo vetëm marshin, po kushdo që organizon një protestë, një diçka në lidhje me këtë padrejtësi që ka ndodhur ndaj ish-krerëve të UÇK-së, ne do të jemi me ta. Prandaj, ne edhe pesë protesta të tjera i kemi pasur jo vetëm në Kosovë, i kemi pasur në Shqipëri, në Maqedoni të Veriut, në Hagë edhe në Strasburg. Shembull kemi dhënë. Në Hagë në Holandë, autoritetet e sigurisë atje na kanë përgëzuar për qytetarinë që kemi treguar atje me rastin e protestës që kishim atje. Prandaj, protestat e tjera edhe marshi do të jetë i qetë. Nuk kemi synim tjetër. Synimi ynë është i gjithë populli me u sensibilizuar edhe me dërguar një mesazh të bashkësisë ndërkombëtare, përkatësisht te drejtësia ndërkombëtare, që bashkë jemi me bashkëkombësit tanë, bashkë ndiejmë me ta. Ata janë të pafajshëm edhe duhet të kthehen në shtëpitë e tyre të pafajshëm”, tha Syla.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar se është i shqetësuar për marshin e paralajmëruar më 12 shtator në Prishtinë, në mbështetje të ish-presidentit Hashim Thaçi dhe ish-krerëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjate nje vizite ne veri te Serbise, Vuçiq pretendoi se organizatoret presin lirimin e I haçit dhe se kane paralajmeruar dhune nese kjo nuk ndodh.

Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)



- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)



- [“I ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i dehur gjobitet 2 herë brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksidenti i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Lajme

- [00:05 / E Hënë, 07 Shtator](#)
[26-vjeçari plagoset me thikë në Tiranë](#)
- [23:25 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Një person me probleme shëndetësore u shkakton lëndime dy familjarëve, arrestohet nga policia](#)
- [23:13 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Tragjike në Rahovec: I mituri gjendet i plagosur me armë zjarri, mjekët konstatojnë vdekjen](#)
- [22:56 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Dyshohet se sulmuan kapitenin Besart Ahmeti, dy të dyshuarit janë djemtë e këtij polici](#)
- [22:28 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Gjendet pa shenja jete një person në Mitrovicë](#)
- [22:10 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: 20 vatra zjarri në vend, 11 mbeten aktive](#)

TEL Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666 EMAIL info@indeksonline.net marketing@indeksonline.net [Indeksonline.net](https://indeksonline.net)



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.